



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4312/1 Prot.

Lezhë më 16.4 .2025

URDHËR

Nr. 205 datë 16-4 2025

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË KËSHILLTARËVE TË ETIKËS, NË
BASHKINË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1 gërma “b”, të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 737 datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për reformën në administratën publike 2023-2023, shkresës nr.2357 prot., datë 07.04.2025, protokolluar nga ana jonë me nr. 4312 prot., 09.04.2025, të Departamentit të Administratës Publike, me lëndë “Mbi njoftimin e dokumentave të etikës për administratën publike”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të Këshilltarëve të Etikës, pranë Bashkisë Lezhë, të përbërë nga:
 1. Znj. Albana Nikolli – Përgjegjës Sektori, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
 2. Znj. Sara Ndoci – Specialist Juriste, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
 3. Znj. Lindita Prenga – Specialist i Regjistrimit Qëndror të Personelit, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Grupi i këshilltarëve të etikës është përgjegjës për këshillimin e çdo nëpunësi të administratës publike për detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për standartet e sjelljes etike.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen këshilltarët e etikës, pranë Bashkisë Lezhë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

